



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Drejtuar:

OE “HTM” sh.p.k.

me NIPT K97006004D

Shkodër, Lagja Perash, Rruga “Rrojej”, Nr 44

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☐

OE “Transport Highway Consulting” sh.p.k.

me NIPT K51428048I

Adresa: Tiranë, Komuna e Parisit, Rruga “Osman Myderizi”, pallati “Shkreli”

Tipi i Kontratës: Punë.

Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur – me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedures: REF-71635-12-10-2025.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: Datë 11.12.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike:

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 79, datë 15.12.2025.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “G.C.A” sh.p.k.**me NIPT L61619031A**

Vlera 9,753,348 (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e tetë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. OE “HTM” sh.p.k**me NIPT K97006004D**

Vlera 9,979,249.40 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzet e nente pikë dyzet) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. OE “MANE/S” sh.p.k**me NIPT J64103865K**

Vlera 10,928,892 (dhjetë milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. OE “Ndertuesi 2000” sh.p.k**me NIPT J96409033R**

Vlera: 11,338,710 (njëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dhjetë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. OE “G & M Construction 07” sh.p.k**me NIPT M21313027A**

Vlera 11,613,449.4 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e nëntë pikë katër) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**1. OE “G.C.A” sh.p.k., me NIPT L61619031A, për arsye se:**

Vlera 9,753,348 (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e tetë) Lekë pa TVSH.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk rezulton që OE të disponojë punëtorin manovrator të kërkuar në këtë kriter, i cili mund të plotësohet duke e patur punonjësën e kërkuar të punësuar apo të kontraktuar me kontratë noteriale.

Në dokumentet e paraqitura në SPE, OE ofertues ka paraqitur si eskavatorist punonjësën K.S., duke theksuar “*me profesion teknik, i punesuar pranesh shoqerise sone, ne rolin e*

punonjes i specializuar ndertimi si dhe eskavatorist sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender”, pa paraqitur dëshminë e kualifikimit për manovrator nga DPSHTRR ose ente të tjera të akredituara për këtë qëllim.

Në listëpagesën e paraqitur nga OE ofertues rezulton që punonjësi K.S. të jetë i regjistruar me Kodin 3119.15, në seksionin “Detyra, Funkcioni, Profesioni apo Puna që ka kryer punonjësi”. Gjithashtu në kontratën e punës të paraqitur nga OE, për punonjësin K.S. në Nenin 1 “Puna që do të Kryhet” citohet se: *“I punesuari pranon te kryje detyren e taknik ndertimi/ punonjes ndertimi / sipas nevojave profesionale te punes dhe te shoqerise, prane “G.A.C.sh.p.k.”*

Referuar VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” rezulton se Kodi 3119.15, me të cilin OE ofertues ka regjistruar punonjësin K.S. përfaqëson profesionin “Teknik ndërtimi” dhe jo “Manovrator” sipas kërkesës së DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE **“HTM” sh.p.k., me NIPT K97006004D**, Adresa: Shkodër, Lagja Perash, Rruga “Rrojet”, Nr 44, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **9,979,249.40 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzet e nëntë pikë dyzet) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.